



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:235737

Datë: 30.04.2024

Numri i dokumentit: 05644484

Ac.nr.3770/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hysni Bardheci-kryetar i kolegjit, Bujar Muzaqi dhe Enes Mehmeti, anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Robertina Lekaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit F.K. nga Prishtina, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokatura M.B.N. sh.p.k, me avokatë M.S., B.S. dhe N.S., që të gjithë nga Prishtina, kundër të paditurës K.S. “S.”, me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson F.C.-M., me bazë juridike kompensimi i dëmit jo material dhe material, sipas auto përgjegjësisë, duke vendosur sipas ankesës së palës së paditur, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2714/15, të datës 09.03.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 18.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET pjesërisht e pathemeltë ankesa e të paditurës K.S. “S.”, me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2714/15, i datës 09.03.2022, në pikën I, dhe IV të dispozitivit, **VËRTETOHET**.

II. APROVOHET pjesërisht e themeltë ankesa e të paditurës K.S. “S.”, me seli në Prishtinë, **NDRYSHOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2714/15, i datës 09.03.2022, në pikën II të dispozitivit që ka të bëjë me kamatën dhe në këtë pjesë gjykohet si në vijim: **DETYROHET** e paditura K.S. “S.”, me seli në Prishtinë, që paditësit F.K. nga Prishtina, t’ia paguaj shumën prej 1,436.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% vjetore, ashtu që kamata për dëmin jo-material të paguhet duke filluar nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë datë 09.03.2022 e deri në pagesën definitive, ndërsa për dëmin material duke filluar nga dita e paraqitjes së padisë datë 13.11.2015, e deri në pagesën definitive.

III. Pika III e dispozitivit të aktgjykimit të atakuar mbetet e pashqyrtuar.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin e atakuar C.nr.2714/15, të datës 09.03.2022, ka vendosur si në vijim: “I. APROVOHET si pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësit F.K. nga Prishtina, ashtu që: DETYROHET e paditura K.S.S., me seli në Prishtinë që paditësit t’ia kompensoj në emër të dëmit jo material dhe material, të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit të datës 06.09.2015, nga baza e auto përgjegjësisë, për 50% të përgjegjësisë, shumat si në vijim: Në emër të dëmit jo material, -për të gjitha llojet e dhimbjeve, shumën prej 600.00 Euro; - për shkak të frikës, shumën prej 420.00 Euro; Për shëmtim trupor, shumën prej 200.00 euro. Në emër të dëmit material, - për ushqimit të përforcuar shumë prej 105.00 Euro; -për ndihmën e huaj, në shumë prej 105.00 Euro; - për shpenzimet mjekësore, në shumë prej 6.00 Euro.

II. DETYROHET e paditura K.S. S., me seli në Prishtinë, që shumat e gjykuara si në pikën - I - të këtij dispozitivi në shumën e përgjithshme prej 1,436.00 Euro (me fjalë: një mijë e katërqind e tridhjetë e gjashtë Euro), t’ia paguaj paditësit me kamatë ligjore prej 12%, ashtu që kamata për dëmin jo-material të paguhet duke filluar nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi (datë: 09.03.2022) e deri në pagesën përfundimtare, ndërsa për dëmin material duke filluar nga data 22.10.2015 (data e paraqitjes së kërkesës tek e paditura) e deri në pagesën përfundimtare, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përbarimit të detyrueshëm.

III. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadiës, përtej shumave të gjykuara si në pikën - I - të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë në emër të kompensimit për të gjitha llojet e dhimbjeve, shuma prej 2,900.00 Euro, në emër të frikës së përjetuar dhe cenimit të dinjitetit njerëzor shuma prej 2,080.00 Euro, në emër të shëmtimit trupor shuma prej 2,800.00 Euro, në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej 95.00 Euro, në emër të ndihmës së huaj shumën prej 95.00 Euro, në emër të shpenzimeve mjekësore shumën prej 6.00 euro dhe në emër të kompensimit për shpenzimet e rehabilitimit në shumë prej 300.00 euro, si të pabazuara.

IV. DETYROHET e paditura që në emër të shpenzimeve procedurale t’ia paguaj paditësit shumën në lartësi prej 938.00 Euro, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit me detyrim”.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka ushtruar ankesë e paditura, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe vendimit mbi shpenzimet e procedurës, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën si të bazuar, aktgjykimin e atakuar ta ndryshoj duke aprovuar shumat me të ulëta ose aktgjykimin e atakuar ta prish dhe ta kthej lëndën në rishqyrtim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur paditësi.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 194, 195, dhe 200 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e të paditurës është pjesërisht e themeltë

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi përmes përfaqësuesit të autorizuar, me datë 13.11.2015, në gjykatën e shkallës së parë, ka parashtruar padi kundër të paditurës, për kompensimin e dëmit sipas bazës së autopërgjegjësisë, të pësuar në aksidentin e komunikacionit të datës 06.09.2015, në fshatin ..., magjistralja Prishtinë-Podujevë. Me parashtrësën e dorëzuar në gjykatë me datë 30.12.2021, pala paditëse ka bërë precizimin e kërkesëpadiës bazuar në mendimin e dhënë nga ekspertet mjekësor, ashtu që ka kërkuar që të miratohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadija e paditësit, dhe të detyrohet e paditura që paditësit t'ia kompensojë në emër të dëmit jomaterial dhe material shumë e përgjithshme prej 9,712.00 euro, me kamatë në lartësi prej 12% duke filluar nga data e paraqitjes së kërkesës për dëmshpërblim e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit e nën kërcënim të përbarimit. E paditura përmes përgjigjes në padi e ka kontestuar bazën juridike të kërkesëpadiës dhe lartësinë e saj, ndërsa gjatë shqyrtimit gjyqësor me paditësin janë pajtuar në ndarjen e përgjegjësisë 50-50.

Gjykata duke vepruar sipas padisë dhe kërkesëpadiës së precizuar të paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse, si dhe vlerësimit të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar me numër C.nr.2714/15, të datës 09.03.2022, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se me provat e administruara, është vërtetuar së aksidenti i komunikacionit ka ndodhur me datën 06.09.2015, rreth orës 08:04 minuta, në fshati ..., magjistralja Prishtinë-Podujevë, i cili aksident është shkaktuar nga i siguruari i të paditurës me policë të sigurimit nr... Gjykata me rastin e caktimit të lartësisë për shpërblimin e dëmit jo material dhe material ka vendosur duke marrë për bazë ekspertizat mjekësore të dhëna nga Dr.N.D., ortoped-traumatolog dhe Dr.Sh.H.-psikiatër, të cilët kanë dhënë mendimin e tyre profesional me ekspertizën e datës 23.12.2021, lidhur me natyrën, shkallën dhe pasojat e lëndimeve që ka pësuar paditësi si pasojë e këtij aksidenti, i njëjti ka pësuar lëndime të lehta trupore, duke konstatuar se ka pësuar përdredhje të qafës, shtypje të mesit, plagë prerëse-shkyese në regjionin e shuplakës së majtë, shtypje dhe gërvishje të shuplakës së djathtë. Paditësi ka pësuar dhimbje të intensitetit posaçërisht të rëndë në kohëzgjatje prej 20 minutave, dhimbje të intensitetit të rëndë në kohëzgjatje prej 24 orë, dhimbje të intensitetit të mesëm në kohëzgjatje prej 7 ditësh, ndërsa dhimbje të intensitetit të ulët ka edhe sot e kësaj ditë posaçërisht gjatë sforcimeve fizike dhe ndryshimeve klimatike. Paditësi, ka përjetuar frikë primare me kohëzgjatje prej 1-2 sekondave, frikë sekondare të intensitetit të lartë ka përjetuar 3 orë, frikë sekondare të intensitetit të mesëm ka përjetuar 1 muaj dhe frikë sekondare të intensitetit të ulët që ka zgjatur edhe 2 javë të tjera vijuese. Paditësi ka pasur nevojë për ndihmën e personit të tretë në kohëzgjatje prej 30 ditësh, për ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej 30 ditësh, ka pasur nevojë për rehabilitim fiziatrik 2 herë nga 7 ditë, ndërsa i njëjti ka pasur shëmtim trupor në shkallë të ulët ndërsa nuk ka zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor. Gjykata e ka refuzuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit, si në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, për dëmin material dhe jomaterial përtej shumave të

gjykuara, sepse bazuar në mendimet e ekspertëve mjekësor ka vlerësuar se shumat e kërkuara nga paditësi për dëmin përtej shumave të gjykuara nuk janë në proporcion me të mirën e shkelur dhe qëllimin e kompensimit.

Gjykata e shkallës së parë, lidhur me bazën juridike të kërkesëpadiisë dhe lartësinë e kërkesëpadiisë, ka vendosur duke u mbështetur në dispozitat e nenit 154, 178.1, 183 dhe 192 të LMD-së, Lidhur me kamatën, gjykata ka vendosur duke u mbështetur në dispozitat e nenit 382 të LMD-së, nenit 26, paragrafi 1, 2, 4, 5, dhe 6 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia si dhe Mendimit Juridike të Gjykatës Supreme të Kosovës për kamatën nr.265/2020 të datës 01.12.2020, pika XII, XIV dhe XV, ndërsa vendimin për shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit të Kosovës, nisur nga kjo gjendje e çështjes, vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, përveç dispozitave të së drejtës materiale ku është bazuar vendimi për kamatën e gjykuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndron pretendimi ankimor se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore për të cilat pretendon pala ankuese. Aktgjykimi nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet dhe në lidhshmëri me këtë dispozitiv i aktgjykimit është i qartë dhe arsyetimi përmban arsye të mjaftueshme për të gjitha faktet vendimtare, të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosur lidhur me themelësinë e kërkesëpadiisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre. Gjykata në arsyetim të aktgjykimit të atakuar ka paraqitur arsye mjaftueshme me lartësinë e dëmit jo material dhe material, si dhe ka dhënë arsye të mjaftueshme për shumat e aprovuara për llojet e dëmit dhe format e tij të kërkuara nga paditësi.

Gjykata e Apelit vlerëson se janë të paqëndrueshme pretendimet e ankimore të paditurës për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, sepse vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, ku baza juridike e kërkesëpadiisë nuk ishte kontestuese mes palëve ndërgjyqëse, pasi që palët janë pajtuar për ndarje të përgjegjësisë 50-50, ndërsa lartësinë e kërkesëpadiisë e ka vërtetuar në bazë të mendimeve të ekspertëve mjekësor nga lëmi i ortopedisë-traumatologjisë dhe psikiatrisë, të cilët gjatë ekzaminimit e dokumentacionit mjekësor, kanë konstatuar qartë natyrën dhe llojin e lëndimeve trupore, kohëzgjatjen dhe intensitetin e dhimbjeve fizike dhe të frikës, kohëzgjatjen e nevojës për ndihmën e huaj dhe ushqimin e përforcuar, andaj edhe kjo gjykatë vlerëson se konstatimet e ekspertëve janë profesionale dhe me sqarime të mjaftueshme, për tu vërtetuar format e dëmit dhe

lartësia e tyre, ku në bazë të këtyre konstatimeve gjykata edhe ia ka gjykuar shumat për format e dëmit material dhe jomaterial.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë së paditësit, i ka vërtetuar shumat e kompensimit të aprovuara në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, ndërsa ka refuzuar si të pathemeltë ankesën e palës së paditur, sipas së cilës, shumat e kompensimit do të duhej të ishin me të ulëta. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, duke marrë parasysh natyrën e lëndimeve, kohëzgjatjen e dhimbjeve dhe frikës, shkallën e shëmtimit, dhe përgjegjësin e të paditurës në shkallë prej 50%, siç e njëjta e ka pranuar, është vendosur që të vërtetohen shumat e kompensimit në emër të dëmit jo material të shkaktuar, mbështetur edhe në thëniet e ekspertizave mjekësore, ku janë trajtuar këto forma të dëmit. Gjatë vendosjes lidhur me to, gjykata e shkallës së parë, është mbështetur siç duhet në nenin 183 par.2 të LMD-së, (Ligji Nr. 04/L-077) i cili decidivisht thotë se: *“Me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me te mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror”*. Nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore, rezulton se kompensimi duhet të jetë adekuat me natyrën e lëndimit, intensitetin dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve të përjetuara, si dhe frikës së palës së dëmtuar, ashtu që kompensimi të përfaqësojë një lehtësim në përballimin dhe tejkalimin e pasojave të dëmit që në këtë rast pala paditës ka pësuar në aksidentin e ndodhur, e që në të njëjtën kohë, ato të jenë reale dhe të paraqesin satisfakcion të vërtet, për aq sa është e mundur, duke u shkuar për shtati synimeve shoqërore për kompensimin e dëmit. Në kuptim të kësaj, konstatohet se gjykata e shkallës së parë ka vepruar konform një dispozite të tillë.

Në bazë të dispozitës së nenit 179 par.1 të LMD-së, është paraparë së *“Kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet tjera të nevojshme lidhur me këtë, si dhe fitimin e humbur për shkak të paaftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit”*. Në rastin konkret rezulton se në mënyrë të drejtë, gjykata e shkallës së parë ka vendosur edhe mbi shumën në emër të dëmit material, për ushqim të përforcuar, ndihmë të personit të tretë dhe rehabilitim fiziatrik meqë, siç theksohet edhe në ekspertizë mjekësore, paditësi ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar, të pasur me vitamina, proteina dhe albumina për 30 ditë ndihmë të personit të tretë në kohëzgjatje prej 30 ditësh. Edhe pse një formë e tillë e dëmit është më e vështirë për t’u vërtetuar me prova konkrete, praktika gjyqësore e njeh kompensimin e dëmit të tillë, e meqenëse është konstatuar nevoja për ushqim të përforcuar dhe ndihmë të personit të tretë, sepse zakonisht për personat e lënduar kujdeset anëtar i familjes, ndërsa ushqimi i përforcuar zakonisht nuk mund të ndahet nga ushqimi i zakonshëm, atëherë rrjedhimisht dhe ligjërisht, paditësi i takon ky lloj kompensimi.

Lidhur me vendosjen si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, përkitazi me kamatën, Gjykata e Apelit vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës shkallës së parë rreth mënyrës së vendosjes nuk është i drejtë dhe i ligjshëm. Përkundër faktit se aktgjykimi i atakuar rezulton të mos jetë i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, por sipas kësaj gjendje faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë është zbatuar gabimisht e drejta materiale sa i përket kamatës, për çka

në këtë pjesë është dashur që të ndryshohet aktgjykimi i atakuar. Sipas dispozitës së nenit 26, paragrafi 6 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, kamata prej 12%, paguhet: *“Në rast të mosrespektimit të afateve të përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni, dhe mospërbushjes së detyrimit në pagesën e paradhënies nga paragrafi 4. i këtij neni, siguruesi përgjegjës konsiderohet të jetë në vonesë në përmbushjen e detyrimit për dëmshpërblim, duke u ngarkuar me pagesë të interesit për vonesë. Ky interes paguhet në lartësi prej 12 % të interesit vjetor dhe llogaritet për çdo ditë vonesë deri në shlyerjen e dëmshpërblimit nga siguruesi përgjegjës, duke filluar nga data e paraqitjes së kërkesës për dëmshpërblim”*. Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar dispozitën e lartcekur kur paditësit i ka njohur kamatën prej 12%, përkundër faktit se e njëjta ka administruar si provë kërkesën për dëmshpërblim nga autopërgjegjësia të paditësit drejtuar të paditurës me datën 22.10.2015, email-in e të paditurës drejtuar përfaqësuesit të paditësit për plotësimin e dokumentacionit me datën 26.10.2015, si dhe njoftimin e datës 25.02.2016, lidhur me kërkesën për dëmshpërblim. Në bazë të këtyre provave rezulton se e paditura ka vepruar ndaj kërkesës së palës të dëmtuar-këtu paditësit dhe se për këtë arsye nuk janë plotësuar kushtet që të mund të njihet kamata prej 12%, ndërsa është dashur që të zbatohet dispozita e nenit 382, paragrafi 2 të LMD-së, duke i njohur kamatën 8%. Prandaj nga arsyet e theksuara Gjykata e Apelit ka vendosur që ta ndryshoj aktgjykimin e atakuar në pjesën ku është vendosur për kamatën, dhe ka gjykuar si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit, ka vlerësuar se vendimi mbi shpenzimet e procedurës kontestimore është marrë në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestimore, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e neni 449 dhe 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nuk e ka shqyrtuar aktgjykimin e atakuar në pikën III të dispozitivit, pasi që nuk kishte pretendime ankimore në pjesën refuzuese të kërkesëpadisë.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti së Gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195, paragrafi 1, pika d) dhe e), lidhur me nenin 200 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.3770/2022, datë 18.04.2024

Kryetar i kolegjit, Gjyqtari
Hysni Bardheci